



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Prill - Qershor 2008

BULETIN

3 – MUJOR/NR.
PRILL-QERSHOR
2008

PASQYRA E TITUJVE KRYESORË :

1. Monitorime
2. Të drejtat e shtetasve dhe rivendosja e tyre
3. Parandalimi i diskriminimit në shkolla
4. KShH-ja dhe të drejtat e emigrantëve
5. Rritja e kapaciteteve të administratës së burgjeve
6. Projekte të reja
7. Fuqizimi institucional i KShH-së
8. Botime

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it (CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT)

RAPORTI I KSHH-SË PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI, 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit monitoroi respektimin e të drejtave të shtetasve në fushat që janë në misionin e tij. Raporti i bërë publik më 8 maj 2008 trajton çështje të tilla, si: funksionimi i shtetit të së drejtës, procesi i integritimit të Shqipërisë në BE dhe NATO, reforma zgjedhore, respektimi i të drejtave të cilëve u është hequr e drejta e lirisë, media, sistemi i drejtësisë, minoritetet dhe respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë që kalojnë pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë ose që janë kthyer në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit.

Vazhdon në faaen 2

KSHH-JA MONITOROI ECURINË E PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN TË SHQIPËRISË NË FUSHAT E MIGRACIONIT

Më qëllimin për të kontribuar në integrimin më të shpejtë të Shqipërisë në BE KShH-ja monitoroi ecurinë e zbatimit të reformave në politikat e emigracionit dhe menaxhimin e kufijve gjatë vitit 2007 dhe tremujorit të parë të vitit 2008.....

Vazhdon në faqen 2

INSTITUCIONET PENITENCIARE TË REJA KANË NEVOJË PËR PERSONEL TË PËRZGJEDHUR SIPAS STANDARDEVE DHE TË TRAJNUAR NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Më 21-23 prill 2008, 12-14 maj dhe më 2-4 qershor 2008 KShH-ja organizoi trajnime për punonjësit me uniformë të përzgjedhur në institucionin e Fushë-Krujës dhe të paraburgimit në Vlorë. Trajnimet synonin rritjen e aftësi profesionale të personelit...

Vazhdon në faqen 5

Përgatiti buletin: Erida Skëndaj

Administratore zyre/

asistente financiere

Redaktimi letrar: Marie Mato

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. "Gjin Bue Shpata", pall. 5/1,
ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 233671

Cel: 068 20 23 699;

E-mail: office@ahc.org.al

1 MONITORIME

1.1 KSHH-JA MONITOROI DHE PREZANTOI RAPORTIN VJETOR TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit monitoron respektimin e të drejtave të shtetasve në fushat që janë në misionin e tij.

Përfundimet e monitorimit të gjendjes së të drejtave të njeriut për vitin 2007 u paraqitën në një raport i cili i bë publik më 8 maj 2008 në një konferencë për shtyp, në prani të përfaqësuesve të medias elektronike dhe të shkruar.

Në raport trajtohen çështje të tilla, si: funksionimi i shtetit të së drejtës, procesi i integritit të Shqipërisë në BE dhe NATO, reforma zgjedhore, respektimi i të drejtave të shtetasve të cilëve u është hequr e drejta e lirisë, media, sistemi i drejtësisë, minoritetet dhe respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë që kalojnë pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë ose që janë kthyer në kuadër të marrëveshjeve të ripranimit.

Raporti vë në dukje progresin e realizuar në fusha të caktuara si dhe vështirësitë dhe të metat e hasura gjatë vitit 2007 në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut.

Media e shkruar dhe elektronike tregoi interes të gjerë për të. Raportin mund ta lexoni në adresën: www.ahc.org.al

1.2 KSHH-JA MONITOROI ECURINË E PROCESIT TË INTEGRIMIT EUROPIAN TË SHQIPËRISË NË FUSHAT E EMIGRACIONIT

Më qëllimin për të dhënë ndihmesën e vet në integrimin më të shpejtë të Shqipërisë në BE si dhe për të nxitur marrjen e masave për arritjen e standardeve europiane në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut KShH-ja monitoroi ecurinë e zbatimit të reformave në politikat e emigracionit dhe menaxhimin e kufijve gjatë vitit 2007 dhe tremujorit të parë të vitit 2008. Pjesë e këtij procesi ishte edhe analiza e faktorëve dhe e sfidave të hasura gjatë këtij procesi si dhe nevoja e bashkëpunimit me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile në funksion të integritit të Shqipërisë në familjen europiane.

Gjetjet e monitorimit u prezantuan në një tryezë të organizuar nga KShH-ja, më 30 prill 2008. Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave të huaja dhe vendëse që japin ndihmesën e tyre në këtë fushë si edhe përfaqësues të medias. Problematika e paraqitur tërhoqi vëmendjen dhe interesin e pjesëmarrësve.

Kjo veprimtari u realizua falë mbështetjes financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

1.3 DHOMAT E NDALIMIT DHE TË SHOQËRIMIT NË KOMISARIATET E POLICISË NËN VËZHGIMIN E KSHH-SË

Gjatë muajit prill 2008 KShH-ja kreu disa vëzhgime në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit të komisariateve: Lezhë, Laç, Krujë, Korçë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Durrës, Berat, Burrel, Kavajë dhe Tiranë.

Problemet e konstatuara ishin: kushtet e këqija të dhomave të ndalimit dhe të shoqërimit, infrastruktura e amortizuar, mungesa e shtretërve, mbipopullimi, mbajtja në

dhomat e ndalimit të personave me masa sigurie. Me qëllim përmirësimin e situatës, KShH-ja u ka drejtuar letra të hapura sugjestionuese institucioneve shtetërore dhe ka reaguar edhe nëpërmjet deklaratave publike.

Gjithashtu, në saje të misioneve të monitorimit të zhvillura në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit u mundësua identifikimi i rasteve kur në këto dhoma qëndronin ende persona të ndaluar me masë vlerësimi arrest me burg. Raste të tilla u konstatuan në dhomat e ndalimit në Vlorë, Korçë dhe Shkodër.

Për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, KShH-ja reagoi nëpërmjet deklaratave publike, letrave të hapura drejtuar institucioneve shtetërore kompetente, shkresave drejtuar drejtorive përkatëse për marrjen e masave konkrete, takimeve me përfaqësues të këtyre institucioneve etj.

1.4 VËZHGIME SPORADIKE DHE VERIFIKIME TË ANKESAVE TË SHETASVE

Për të verifikuar ankesat e ardhura në KShH, në periudhën prill-qershor 2008 u kryen vëzhgime sporadike në institucionet e vuajtjes së dënimit, në institucionet e paraburgimit dhe në komisarite. Ndhimesë të madhe në realizimin e këtyre verifikimeve dhanë vëzhguesit dhe korrespondentët e KShH-së.

2.0 TË DREJTAT E SHETASVE DHE RIVENDOSJA E TYRE

2.1 SHETASIT IA ADRESOJNË ANKESAT E TYRE KSHH-SË

Gjatë periudhës prill - qershor 2008, në kuadër të ndihmës ligjore falas që ofron, KShH-ja ka trajtuar rreth 150 raste ankesash. Objekti i ankesave ishin: shkeljet e së drejtës së informimit, çështjet e strehimit dhe të ndihmës sociale të shtresave në nevojë, vendimet e padrejta gjyqësore, shkeljet procedurale gjatë proceseve gjyqësore, veprimet arbitrare nga organet e policisë, shkeljet e të drejtave në burgje, paraburgim si dhe në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit etj.

KShH-ja u ofroi shtetasve që i kishin adresuar ankimet e tyre, shërbime të ndryshme, si: këshillime ligjore, asistencë në plotësimin e dokumentacionit, verifikime të ndryshme, monitorime të proceseve gjyqësore, ndërhyrje në institucione të ndryshme shtetërore etj.

KShH-ja ka bashkëpunuar me organizatat të cilat veprojnë në këtë fushë, si: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Ndhima Ligjore Falas, Tiranë dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Nëpërmjet shërbimeve të ofruara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka dhënë ndihmesën e vet jo vetëm në informimin e qytetarëve për fushat në të cilat këto organizata veprojnë, por, njëkohësisht, edhe në shmangien e veprimeve të mbivendosura.

2.2 KSHH-JA REAGON NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në periudhën prill-qershor 2008 KShH-ja doli me 12 deklarata, në fokusin e të cilave kanë qenë: problemet e konstatuara nga trajtimi i letrave dhe ankesave, kushtet në komisaratin e Vlorës, parandalimi i dhunës në stadione, dhuna ndaj gazetarëve, transparenca dhe vëmendja në mbrojtje të të drejtave të minoritëve, etika parlamentare si dhe reformat e rëndësishme institucionale, siç është reforma zgjedhore, të cilat janë tregues i drejtpërdrejtë dhe i rëndësishëm i shtetit ligjor të së drejtës.

2.3 KSHH-JA NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË SHTETASVE- VIKTIMA TË SHKELJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT

2.3.1 TRYEZE E RRUMBULLAKET PER NDIHMEN LIGJORE FALAS

Më 1 prill 2008 KShH-ja zhvilloi tryezën e rrumbullakët për rolin e shoqërisë civile në ofrimin e ndihmës ligjore falas ndaj shtetasve, të drejtat e të cilëve janë cenuar nga përfaqësues të autoriteteve shtetërore. Qëllimi i tryezës ishte paraqitja e përvojës së KShH-së dhe shkëmbimi i mendimeve me përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime ligjore dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme për një shërbim ligjor më efektiv.

Në përfundim të diskutimit pjesëmarrësit theksuan nevojën *e miratimit sa më shpejt të ligjit "Për shërbimin ligjor falas"*, si një institut i veçantë, *rritjes së bashkëpunimit të organizatave që ofrojnë shërbime ligjore, trajnimit të avokatëve që ofrojnë shërbim avokator falas dhe të avokatëve privatë*. Në tryezë morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve shtetërore.

3.1 PARANDALIMI I DISKRIMINIMIT NË SHKOLLA- NËN FOKUSIN E KSHH-SË

3.1 SEMINARE TRAJNUESE ME MËSUES PËR PARANDALIMIN E DISKRIMINIMIT NË SHKOLLA

Me synim parandalimin e diskriminimit në shkolla të fëmijëve të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian, gjatë muajit qershor 2008, në bashkëpunim me Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale, KShH-ja organizoi dy seminare trajnuese në rrethet Korçë dhe Elbasan me përfaqësues të drejtorive arsimore, si dhe me drejtues dhe mësues të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare.

Origjina, tradita, mënyra e jetesës, problemet e arsimimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë, parë këto në këndvështrimin e shoqërisë civile, si dhe fryma e rekomandimeve ndërkombëtare në këtë fushë ishin disa nga temat e trajtuara në këto aktivitete.

Seminaret trajnuese tërhoqën vëmendjen e pjesëmarrësve për karakterin e tyre interaktiv dhe informacionet e pasura të përcjella si nga situata aktuale e minoritetit rom dhe e komunitetit egjiptian në Shqipëri, ashtu edhe për praktikën e sjellë përmes rekomandimit nr. 10 të Komisionit European kundër Racizimit dhe Intolerancës. Këto aktivitete u pasqyruan edhe në median lokale.

Këto veprimtari u realizuan falë mbështetjes finaciare të fondacionit SOROS.

3.2 PËR NJË STRATEGJI INFORMIMI PËR TË DREJTAT E EMIGRANTËVE

Me synim përmirësimin e informimit të emigrantëve shqiptarë për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e integritit të tyre ose të procesit të kthimit vullnetar në Shqipëri, KShH-ja ka ofruar disa mendime për draftin "Strategjia e informimit dhe e komunikimit për çështjet e emigracionit", përgatitur nga IOM-i në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, të Çështjeve Sociale dhe të Shanseve të Barabarta (MPÇSHB). Strategjia është një

instrument efikas për menaxhimin e emigracionit dhe nevojat për komunikimin dhe informimin më të mirë të emigrantëve shqiptarë kudo që ata ndodhen.

KShH-ja vlerësoi punën e bërë nga IOM-i dhe ministria përkatëse dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim për një mbrojtje dhe informim më të mirë të emigrantëve për të drejtat e tyre.

3.3 KSHH-JA U VJEN NË NDIHMË EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË ITALI

Për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve shqiptarë që jetojnë në Itali, Komiteti Shqiptar i Helsinkit përgatiti një broshurë informuese me informacion ligjor për emigrantët shqiptarë që ndodhen në Itali lidhur me: kartën e qëndrimit, rastet e dëbimit, shërbimet ligjore falas, kujt mund t'i drejtohen emigrantët shqiptarë në rast se të drejtat e tyre shkelen ose ata janë objekt diskriminimi dhe racizmi, shërbimet që ofron ambasada shqiptare në Itali etj.

Në përgatitjen e kësaj broshure, KShH-ja bashkëpunoi ngushtë me ambasadën shqiptare në Romë dhe me ekspertë me përvojë në fushën e migracionit të legjislacionit italian.

3.4 KSHH-JA BASHKËPUNON ME INSTITUCIONET SHTETËRORE NË NIVEL VENDOR NË LUFTËN KUNDËR MIGRACIONIT TË PARREGULLT

3.4.1 ORGANET E QEVERISJES VENDORE LUAJNË ROL TË RËNDËSISHËM NË PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT

Për të forcuar bashkëpunimin mes institucioneve vendore për bashkërendimin e punës në luftën kundër migracionit të parregullt, gjatë muajit prill 2008 KShH-ja organizoi dy tryeza të rrumbullakëta në Burrel dhe në Pukë.

Nga diskutimet në tryezë dolën disa probleme, si: niveli i ulët i informacionit për migrimin e ligjshëm, nevoja e përmirësimit të gjendjes ekonomike dhe e zbutjes së varfërisë dhe të papunësisë në rrethet veriore, përmirësimi i kapaciteteve profesionale të përfaqësuesve të institucioneve vendore, nxitja e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve shtetërore qendore dhe atyre vendore, aktorëve të shoqërisë civile, medias dhe biznesit.

Në këto tryeza morën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithsme të Policisë, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Shërbimit Social Shtetëror, bashkisë, prefekturës, këshillit të qarkut, drejtorisë së policisë së qarkut, zyrës rajonale të shërbimit të punësimit dhe shërbimit social si edhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse vendëse.

3.4.2 INSTITUCIONET ARSIMORE DHE ROLI I TYRE INFORMUES DHE SENSIBILIZUES NË PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT

Në muajin prill 2008 KShH-ja organizoi në Burrel dhe në Pukë dy tryeza të rrumbullakëta me temë "Roli edukues i shkollës në ndërgjegjësimin e të rinjve për parandalimin e migracionit të parregullt".

Tryezat e zhvillura në përputhje me Planin kombëtar të zbatimit të MSA-së synonin rritjen e rolit të shkollës në ndërgjegjësimin e të rinjve për parandalimin e migracionit të

parregullt, si dhe informimin më të mirë të tyre për mundësitë e migracionit të rregullt. Temat kryesore të trajtuara ishin: nevoja e botimit të materialeve informuese dhe sensibilizuese si rezultat i mungesës së informacionit të mësuesve dhe të rinjve në këtë fushë, nevoja e bashkëpunimit më të mirë si dhe ngritja e kurseve trajnuese dhe shkollave profesionale për të rinjtë që duan të migrojnë jashtë vendit për qëllime punësimi.

Në këto tryeza kontribuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të institucioneve arsimore të Burrelit dhe të Pukës si dhe përfaqësues nga bordet e prindërve dhe qeveritë e nxënësve. Përfundimet dhe sugjerimet kryesore të tryezave iu bënë të njohura institucioneve përgjegjëse shtetërore.

Këto veprimtari u realizuan me mbështetjen financiare të dy partnerëve të KShH-së: CORDAID-it dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

3.5 VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE NË NDIHMË TË EMIGRANTËVE

Për të ndihmuar në informimin e emigrantëve shqiptarë në Itali dhe në Greqi lidhur me të drejtat dhe rrugët e mbrojtjes së tyre, KShH-ja ka përgatitur broshura që synojnë të japin informacione të rëndësishme lidhur me të drejtat e emigrantëve të parashikuara nga legjislacioni Italian; shërbimet përkatëse që ofrojnë në ndihmë të emigrantëve institucionet kryesore shtetërore shqiptare, si ambasadat dhe zyrat konsullore si dhe organizatat vendëse dhe të huaja.

Këto botime u realizuan falë mbështetjes financiare të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

4.0 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PARABURGOSUR DHE TË DËNUAR- MES RRRITJES SË KAPACITETEVE TË ADMINISTRATËS, TË VENDEVE TË PARABURGIMIT DHE BURGJEVE

4.1 TRAJNIM ME DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE PENITENCIARE

Në datat 1-3 prill 2008 KShH-ja organizoi një trajnim me drejtuesit e institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim. Znj. Mirjam Dierckxsens, z. Jan van den Brand dhe z. Jacques van Huet, ekspertë me përvojë në këtë fushë, dhanë ndimesën e tyre.

Trajnimi u përqendrua në çështje me rëndësi, si: planifikimi dhe delegimi, dhënia e informacionit dhe reagimi ndaj tij, marrja e vendimeve, planifikimi i veprimtarive dhe lidhja midis tyre, përcaktimi dhe alokimi i burimeve në institucion etj.

Pjesëmarrësit u pajisën me materiale të dobishme trajnuese. Ata vlerësuan cilësinë e trajnimit dhe trajtimin praktik të çështjeve.

4.2 INSTITUCIONET PENITENCIARE TË REJA KANË NEVOJË PËR PERSONEL TË PËRZGJEDHUR SIPAS STANDARDEVE DHE TË TRAJNUAR NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në datat 21-23 prill 2008, 13-15 maj dhe 2-4 qershor 2008 KShH-ja organizoi trajnime për punonjësit me uniformë të përzgjedhur rishtas në institucionin e Fushë-Krujës dhe në institucionin e paraburgimit të Vlorës. Trajnimet synonin rritjen e aftësive profesionale të

personelit lidhur me funksionimin e përditshëm të burgut dhe me trajtimin njerëzor dhe me dinjtet të personave të cilëve u është hequr e drejta e lirisë.

Temat e trajtuara në trajnime ishin: misioni dhe vizioni i sistemit penitenciar në Shqipëri, struktura organizative e një burgu, kujdesi për personelin, përzgjedhja dhe trajnimet bazë, aftësitë profesionale dhe qëndrimet ndaj të dënuarve, krijimi i një klime të sigurt, struktura e komunikimit, përdorimi i forcës, menaxhimi i konflikteve, diferencimi i të dënuarve dhe veprimtaritë ditore. Tema të trajnimeve ishin, gjithashtu: Kodi i sjelljes, si një politikë e integritetit në burgje; të dënuarit dhe kontaktet me botën jashtë; politikat disiplinore; kërkesë-ankesat dhe protokollet.

Në këto trajnime dhanë ndihmesën e tyre ekspertët z. Boeij Cees, z. De Groen Theo, z. Poll Kees, z. Van Den Brand Jan, z. Verschure Hattinga Joostm z. Bertelink Hans, znj. Elanders Yola dhe z. John Nijhuis.

Diskutimi në grup, i shoqëruar më pas me vizitat në mjediset e brendshme të burgut, mundësoi gërshetimin e njohurive teorike dhe praktike. 168 punonjës me uniformë u trajnuan dhe u pajisën me certifikata për përfundimin me sukses të këtij trajnimi bazë. Ata vlerësuan trajnimin dhe metodologjinë e përdorur.

4.3 MBËSHTETJE E PROCESIT TË HARTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË QENDRËS SË TRAJNIMIT TË BURGJEVE

Më 4 prill 2008, KShH-ja, së bashku me ekspertët Vesna Babic dhe Jan van den Brand, shqyrtuan variantin paraprak të planit të veprimit të qendrës së trajnimit të burgjeve për vitet 2008-2010. Ekspertët ofruan sugjerime konkrete për përmirësimin e këtij plani në mënyrë që ai të marrë formën e tij përfundimtare dhe të shërbejë si dokument i cili parashikon transformimin e sektorit të trajnimeve në qendër të mirëfilltë trajnimesh. Pritet që grupi i punës nga DPB-ja ta finalizojë planin e veprimit dhe ky dokument të shoqërohet me përllogaritje financiare për të mundësuar transformimin e dëshiruar.

4.4 HARTIMI I MANUALIT TË DREJTIMIT TË LARTË TË BURGJEVE

Më 10 prill 2008 dhe 16 maj 2008 u zhvilluan 2 takime me grupin e punës që është caktuar për hartimin e Manualit të drejtimit të lartë të burgjeve. Deri tani është rënë dakord për strukturën dhe disa prej kapitujve që janë punuar nga specialistë shqiptarë me ndihmën e ekspertëve të huaj. KShH-ja dhe ekspertët e saj po asistojnë dhe po japin ndihmesën e tyre në këtë proces.

Ky aktivitet zbatohet në kuadër të projektit 'Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare', mbështetur nga UNICEF, Shqipëri dhe financohet nga CARDS 2004 dhe SIDA.

4.5 HARTOHET PROGRAMI MËSIMOR I QENDRËS SË TRAJNIMIT TË BURGJEVE¹ PËR TRAJTIMIN E TË MITURVE NË INSTITUCIONET E PARABURGIMIT DHE BURGJET

Në datat 2-4 qershor 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një sesion pune për hartimin e programit mësimor të qendrës së trajnimit të burgjeve (QTB) me qëllim trajnimin bazë të personelit me uniformë të përzgjedhur rishtas për trajtimin e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe burgjet. Ky modul trajnimi hartohet për herë të parë

në sistemin e burgjeve shqiptare dhe vjen në një kohë të përshtatshme, pasi kanë filluar procedurat e hapjes së tri insitucioneve të reja penitenciare që do të kenë sektor të veçantë për të miturit. Për më tepër, nevoja e trajnimit ndihet edhe në institucionet e paraburgimit që kanë përzgjedhur personel të ri.

Në përfundim të këtij sesiioni pune, me mbështetjen e znj. Jet Gudden, eksperte ndërkombëtare nga Agjencia Holandeze e Institucioneve të Korrektimit dhe znj. Klejda Ngjela, asistente e programit në KShH, pjesëmarrësit e grupit të punës hartuan një program konkret trajnimi me këto tema: klima e sigurt, sjellja profesioniste, intervistimi motivues, programet ditore, aftësitë sociale.

Në dhënien e trajnimeve në të ardhmen, Komiteti Shqiptar i Helsinkit rekomandon përfshirjen e trajnerëve nga institucionet e burgjeve shqiptare të trajnuar nga KShH-ja.

4.6 PREZANTIMI I MANUALIT TË ZBATIMIT TË REGJIMIT

Në datat 11 prill 2008 dhe 23 maj 2008 KShH-ja organizoi 2 sesione pune me stafin e nivelit të lartë drejtues në institucionin e paraburgimit të Vlorës dhe në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale të Fushë-Krujës. Në këto sesione mbështetëse dha ekspertizën tij z. Jan van den Brand, ekspert në fushën penitenciare. Znj. Edlira Papavangjeli, menaxhere e programit moderoi këto sesione.

Gjatë këtyre sesioneve u ofrua një praktikë e mirë për procesin e hapjes dhe të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve. Pjesë e sesioneve ishte, gjithashtu, njohja e pjesëmarrësve me manualin për zbatimin e regjimit në institucion dhe epërsitë e hartimit të këtij manuali për institucionet përkatëse. Grupet e punës të këtyre institucioneve po punojnë për hartimin e procedurave të shkruara të cilat do të ndihmojnë për një mirëfunksionim të këtyre institucioneve.

4.7 TAKIME ME AKTORË TË NDRYSHËM DHE AUTORITETET SHTETËRORE NË FUSHËN PENITENCIARE

Gjatë periudhës prill- qershor 2008 janë realizuar takime të ndryshme pune me përfaqësues të UNICEF-it dhe gjithë rrjetit të organizatave që bashkëpunojnë në fushën e drejtësisë për të miturit. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka dhënë mendime ligjore për propozimet për ndryshime të Kodit penal dhe të ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale" lidhur me ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të provës.

Në kuadër të vlerësimit që i është bërë sistemit të drejtësisë për të miturit në vendin tonë, proces ky i realizuar nga UNICEF-i, KShH-ja ka ofruar mendime dhe sugjerime për trajtimin e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe burgjet, nevojat, problemet, sfidat për përmirësimin e situatës në këtë fushë. Në këtë vlerësim, KShH-ja u përfaqësua nga znj. Edlira Papavangjeli, menaxhere e programit.

Krahas trajnimeve të stafit në burgje, përfaqësues të KShH-së dhe ekspertë të saj kanë marrë takime me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me probleme të ndryshme në fushën e menaxhimit të burgjeve. Në takime kanë marrë pjesë znj. Edlira Papavangjeli, menaxhere e programit dhe z. Jan van den Brand, ekspert në fushën penitenciare dhe përfaqësues i Agjencisë së Institucioneve të Korrektimit në Holandë.

KShH-ja ka marrë pjesë në takime të herëpashershme me përfaqësuesin përgjegjës për fushën penitenciare të misionit të EURALIUS-it dhe anëtarëve të Konsorciumit Ndërkombëtar, ku KShH-ja është anëtar.

5.0 PROJEKTE TË REJA

5.1 PËR NJË RESPEKTIM MË TË MIRË TË TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE NGA SHKELJET E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE – KLINIKA LIGJORE

Në muajin prill të 2008-ës filloi zbatimi i fazës së dytë të projektit për ofrimin e shërbimit ligjor falas Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i shtetit ligjor nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të grupeve të cënueshme nga veprimet abuzive të administratës shtetërore.

Shërbimet që do të ofrohen, janë: trajtimi, verifikimi, këshillimi ligjor, asistimi në plotësimin e dokumentacioneve ligjore, ndërhyrja në institucionet shtetërore si dhe, në raste të veçanta, përfaqësimi i çështjeve në gjykatat shqiptare dhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Përfituesit e shërbimit ligjor falas janë viktimat e ushtrimit të dhunës, të trajtimeve dhe poshtërimeve çnjerëzore, personat e diskriminuar nga personeli i institucioneve shtetërore, si dhe ata që janë cenuar si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor.

Shërbimi ligjor falas është i fokusuar në Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë. Megjithatë nga ky shërbim mund të përfitojnë edhe shtetas të tjerë.

Shërbimi ligjor falas mundësohet falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit.

5.2 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË SHTETASVE NË SHËRBIMIN SHËNDETËSOR- NËN MONITORIMIN E KSHH-SË

Në kuadër të përmbushjes së misionit tonë, më 1 korrik 2008 KShH-ja do të fillojë zbatimin e projektit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, kujdesit shëndetësor dhe social në Shqipëri”, financuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Fondi Federal i Ndihmës.

Nëpërmjet kësaj iniciative KShH-ja do të monitorojë respektimin e të drejtave të shtetasve në institucionet shëndetësore në nivel qendror dhe lokal, në veçanti respektimin e së drejtës së trajtimit të pacientëve kronikë dhe atyre me probleme mendore në institucionet psikiatrike, si dhe respektimin e së drejtës së trajtimit të jetimëve në jetimore dhe të personave të moshuar në azil. Projekti do të zbatohet përgjatë një viti dhe buxheti total i tij është 18 890 US.

KShH-ja është e hapur dhe vlerëson bashkëpunimin me organizata dhe institucione të tjera në këtë iniciativë.

6.0 FUQIZIMI INSTITUCIONAL I KSHH-SË

6.1 KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT PREZANTON PLANIN STRATEGJIK PËR VITET 2008-2010

Në kuadër të transparencës së organizatës dhe nxitjes së bashkëpunimit me aktorë shtetërorë, të shoqërisë civile dhe të rrethit të donatorëve, më 29 shtator 2008 KShH-ja organizoi një takim miqësor me partnerë, përfaqësues të organizatave vendëse dhe të huaja, donatorë, përfaqësues të medias dhe aktivistë të të drejtave të njeriut me synim për të prezantuar planin strategjik të veprimtarisë së tij për vitet 2008-2010.

Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të njeriut në fusha të tilla, si: policia, paraburgimi, burgjet dhe sistemi i drejtësisë, trajtimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe rivendosja e tyre me ndihmën ligjore, mosdiskriminimi dhe monoritetet, si dhe monitorimi i zbatimit të MSA -së, do të jenë përparësitë e KShH-së në tri vitet në vazhdim.

KShH-ja do të vazhdojë të forcojë qëndrueshmërinë e vet duke rritur bashkëpunimin me organizatat e tjera simotra vendëse dhe të huaja me median. Rëndësi do t'i kushtohet forcimit të bashkëpunimit në nivel vendor dhe rrjetit të korrespondentëve të KShH-së.

Partnerë të KShH-së, përfaqësues të institucioneve shtetërore, organizatave vendëse, ndërkombëtare dhe donatorë shprehën nevojën e rritjes së rolit të shoqërisë civile në bashkëpunimin e saj me institucionet shtetërore për demokratizimin e vendit.

6.2 RRRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT TË KSHH-SË

6.2.1 TRAJNIM LIDHUR ME ZBATIMIN E NENIT 8 TË KONVENTËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE PRAKTIKËS SË GJYKATËS SË STRASBURGUT

Me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të juristëve të organizatave të të drejtave të njeriut në rajonin e Ballkanit, në datat 16-18 maj 2008 u organizua një trajnim lidhur me praktikën e Gjykatës së Strasburgut dhe në veçanti lidhur me kuptimin dhe zbatimin e nenit 8 të KEDNJ-së.

Koncepti i së drejtës së jetës familjare, jetës private, të vendbanimit, i së drejtës së korrespondencës, si dhe kuptimi, gjerësia e përmbajtjes dhe kufizimet e këtyre të drejtave nga ana e institucioneve shtetërore ishin tema të trajnimit.

Në këtë trajnim mori pjesë znj. Ersida Sefa. Trajnimi u mbështet nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

6.2.2 TRAJNIM NË GJYKATËN EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në datat 28 - 29 prill 2008, në Strasburg u organizua trajnimi "Sesioni studiues i 12-të, për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut". Trajnimi u organizua në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg nga European Roma Right Center dhe Këshilli i Europës. Në këtë trajnim merrnin pjesë përfaqësues të organizatave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut për shtetet e Europës.

Gjatë trajnimit u trajtuan nenet 6, 8, 13 dhe 14 duke vënë theksin tek aspektet procedurale për përfaqësimin e çështjeve në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në këtë trajnim mori pjesë edhe znj Etilda Saliu, koordinatore e projektit të ndihmës ligjore falas.

6.2.3 TRAJNIM PËR ROLIN AKTIV TË OJF-VE NË GJYKATËN EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në datat 4 - 5 qershor 2008 KShH-ja mori pjesë në trajnimin "Roli aktiv i OJQ-ve në procedurat para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, çështjet relevante substanciale dhe procedurale", organizuar nga Këshilli i Europës. Përfaqësuese të KShH-së në këtë trajnim ishin znj.Ersida Sefa, koordinatore projekti dhe znj.Etilda Saliu, koordinatore e klinikës ligjore.

6.3 FORCIMI I BASHKËPUNIMIT TË KSHH-SË ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE, AKTORË TË SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAN

6.3.1 PJËSËMARRJA NË TAKIME KOORDINUESE

Me synim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimin e nismave të përbashkëta, në periudhën prill-qershor 2008 KShH-ja organizoi takime të ndryshme me përfaqësues të institucioneve shtetërore si dhe me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Takime koordinuese u realizuan me drejtues të Institutit Kombëtar të Diasporës dhe me përfaqësues të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

Gjithashtu, KShH-ja mori pjesë në mbledhjen e Konsorciumit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Integruar të Kufijve ku ngriti shqetësimin për respektimin e të drejtave të njeriut në pikat e kalimit të kufirit dhe për përmirësimin e kushteve. Gjithashtu, KShH-ja vuri në dukje progresin e realizuar në këtë fushë në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të parashikuara në kuadër të procesit të integrimit europian.

6.3.2 RESPEKTIMI I ETIKËS GAZETARESKE NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Më 8 maj 2008, në mjediset e Institutit Shqiptar të Medias, KShH-ja organizoi një seminar trajnues me gazetarë të medias së shkruar dhe asaj elektronike lidhur me rolin e gazetarëve në respektimin e të drejtave të njeriut. Qëllimi i seminarit trajnues ishte rritja e ndërgjegjësimit të gazetarëve për respektimin më të mirë të lirive dhe të të drejtave të njeriut, si bazë e etikës së komunikimit.

Problemet me të cilat ndeshet media shqiptare dhe ndikimet e politikës në objektivitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e pasqyrit të lajmit, nevoja për respektimin më të mirë të Kodit të etikës së gazetarëve në realizimin e detyrës së tyre si dhe nxitja e bashkëpunimit më efikas ndërmjet medias dhe shoqërisë civile, si aktorë të rëndësishëm për demokratizimin e vendit, ishin disa nga çështjet kryesore që u trajtuan në këtë aktivitet.

Pjesëmarrësit në trajnim u informuan, gjithashtu, edhe për raportin që duhet të ekzistojë midis respektimit të rregullave profesionale të gazetarisë dhe etikës së raportimit të lajmit, në themel të së cilës duhet të jetë respekti për të drejtat e njeriut.

6.4 RRRITJA E ROLIT TË MEDIAS NË SENSIBILIZIMIN DHE RESPEKTIMIN MË TË MIRË TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI

Më 15 prill 2008 KShH-ja organizoi një seminar trajnues me studentët e departamentit të gazetarisë me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e të drejtave të njeriut dhe nxitjen e aksesit të gazetarëve të rinj në veprimtarinë e KShH-së.

Roli i shtypit në shoqërinë demokratike, media dhe respektimi i të drejtave të njeriut; raporti i KShH-së me mediat si dhe nevoja e bashkëpunimit të medias me shoqërinë civile ishin disa nga çështjet e trajtuara në këtë seminar trajnues. Studentët u informuan në mënyrë të veçantë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me aspekte të ndryshme të mosdiskriminimit. Gjithashtu, atyre iu dhanë disa udhëzime për mënyrën e përgatitjes së reportazheve në këtë fushë.

Studentët pjesëmarrës përgatitën dhe botuan në median e shkruar ese. Tri punimeve më të mira të tyre iu dhanë çmime të veçanta nga një komision vlerësimi. Dhënia e çmimeve për punimet më të mira shërbeu për motivimin dhe nxitjen e shkrimeve të reportazheve në respektim të të drejtave të njeriut.

7.0 BOTIME

7.1 PJESËMARRJA E MINORITETEVE NË ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Bazuar në monitorimet e realizuara nga KShH-ja për pjesëmarrjen e minoriteteve në organet e qeverisjes vendore dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj tyre, gjatë muajit qershor u përgatën katër botime të veçanta me përfundimet e anketimeve dhe të monitorimeve të realizuara në bashkitë: Elbasan, Fier, Gjirokastrë dhe Tiranë.

Krahas vlerësimeve të përgjithshme të situatës së respektimit të të drejtave të pakicave, synimi i këtyre botimeve ishte t'u ofronin organeve të qeverisjes vendore përfundime dhe rekomandime konkrete për aksesin e minoriteteve në organet e qeverisjes vendore dhe rrugët e përmirësimit të këtij aksesit.

Botimi i këtyre raporteve është me rëndësi, pasi, nga njëra anë ato pasqyrojnë perceptimet e qytetarëve për problemet që ndeshin minoritetet dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjes vendore dhe, nga ana tjetër, pasqyrojnë perceptimet e vetë administratës vendore dhe të organeve të qeverisjes vendore për situatën e të drejtave të minoriteteve në territorin ku ato ushtrojnë kompetencat si dhe nevojën për rritjen e kontributit të pakicave në hartimin dhe zbatimin e politikave vendore të zhvillimit në interes të tyre.

Raportet janë botuar në shqip dhe janë shoqëruar me një përmbledhje në anglisht.